



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/ 559

Procesverbal nga dëgjimi publik me Bizneset

E mërkurë, më 21 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 18:00 –19:40

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit

Pjesëmarrës në takim: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme - Valon Januzi dhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik – Kastriot Shabani

Rendi i ditës:

1.Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, i cili ka përshëndetur të pranishmit dhe ka falënderuar që kanë gjetur kohë që sot të jenë së bashku me ne në këtë dëgjim publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

Z.Ademi më tutje vazhdoi dhe tha se sot është dita fundit që është paraparë për dëgjime publike, prandaj tani u erdhi radha edhe bizneseve.

Dëgjimet publike janë obligim ligjor dhe ne kësisoj jemi të detyruar që t'i mbajmë, ku këtë radhë kemi mbajtur në të gjitha fshatrat dhe kemi marrë kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve për t'i vendosur në buxhetin e vitit 2024. Zakonisht në fshatra flasim për investimet kapitale siç janë kanalizimi, ndriqimi, asfaltimi e trotuari dhe ato kërkesa të cilat i kanë parashtruar qytetarët ne i kemi marrë dhe tani të njëjtën gjë po kërkojmë edhe nga ju, që kërkesat të cilat i keni t'i drejtoni sot para nesh.

Adnan Ademi elaboroi buxhetin e vitit aktual të komunës dhe bëri krahasime me atë të vitit 2024, ku dha informata shtesë për investimet të cilat janë duke u bërë dhe të cilat priten të bëhen në vitin e ardhshëm. Pas përfundimit të fjalimit të tij Z. Ademi ia dha fjalën drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimit Ekonomik, Kastriot Shabani.

Drejtori Shabani falënderoi Kryesuesin dhe ju uroi mirëseardhje të ftuarve, të cilët i falënderoi që sot kanë gjetur kohë që të jenë pjesë e këtij takimi. Më tutje, Drejtori tha se siç e ceku edhe Kryesuesi ne sot ju kemi ftuar që të bëni kërkesat të cilat i keni që së bashku me ne të jeni edhe ju pjesë e procesit të hartimit të buxhetit për vitin e ardhshëm dhe të Kornizës në plan 3-vjeçar.

Z. Shabani dha informata sa i përket drejtorisë së tij dhe investimeve të cilat janë bërë deri tani në parkun e bizneseve në Gllavicë dhe investimeve të cilat priten të bëhen për vitet e ardhshme. Po ashtu ai tregoi edhe disa investime të tjera të cilat do të bëhen së bashku me Drejtorinë e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, te parkut aktual dhe në rrugët të cilat e bëjnë më të lehtë transportin për bizneset.

Kërkesat e Bizneseve:

- **Rexhep Limani:** Hapësira për bizneset dhe infrastruktura janë dy elementet kryesore dhe më të rëndësishme sa i përket bizneseve.
Infrastruktura nuk është në nivelin e duhur, rrugët kanë filluar të prishen, rrugët të cilat na lidhin me qytetet e mëdha janë në gjendje jo të mirë, tranziti më është jashtë funksionimit.
- **Bekim Sinani:** Rruga tek parku i biznesit ka filluar të prishet ku si pasojë e kësaj janë disa gropa të mëdha të cilat e vështirësojnë transportin.
Sa i përket stinës së dimrit mjetet me vështirësi të madhe ngjiten në atë pjesë të rrugës prandaj nëse është mundësia të bindni operatorin për të shtrirë kripë ose gurë më shumë, gjithashtu edhe pastrimi i borës të bëhet më shpesh.
- **Isa Laçi:** Të bëhet një muri mbrojtës për shkak se ka shembje të dheut.
Një shtyllë afër objektit po shfaqë probleme dhe e njëjta është në rrezik të bie.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME



Lista e pjesëmarrësve

Bizneset

Data: 21.06.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi
1	REXHEP ZIMAN	
2	HATIR GASHI	
3	ISA LAÇI	
4	BEKIM SINANI	
5		
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		